



## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e mbajtur më 18.05.2016, e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, kryetar, Dardan Sejdiu, nënkryetar, këshilltarët e Kuvendit: Sami Hamiti, shef i GP-së (LDK), Hazir Borovci (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Flamur Shala (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Lirijeta Rexhepi (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Laura Zherka (PDK), Mirlinda Sopi (AKR), Sami Boroci, (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Abetare Fazliu, përfaqësues e subjektit politik (LB), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik PF, Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik GIS dhe Abit Kastrati.

**Munguan:** Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Shaip Shabani (PDK), dhe Cuneyd Ustaibo, përfaqësues i subjektit politik KDTP.

**Të pranishëm ishin** edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues, dhe hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Sami Hamiti**, në emër të GP të LDK-së, propozoi që në rend të ditës të futet Propozimvendimi për dhënien e garancisë ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban", për marrjen e kredisë nga BERZH-i. Po ashtu i njoftoi të pranishmit se për pikat 2, 3 dhe 4 të rendit të ditës, që kanë të bëjnë me planet rregulluese, tha se për derisa i kemi të gjitha shkresat që nuk janë të ligjshme, në votimin e tyre, ne do të abstenojmë.

Ndërsa sa i përket vendimit që Kuvendi ka marrë për miratimin e kërkesës së një grupi të qytetarëve të lagjes "Prishtina e Re- Zona perëndim", ministria e ka kthyer

përgjigjen e vetë ligjore dhe nuk ka nevojë që për atë pjesë Kuvendi të merr ndonjë vendim tjetër, po të shfuqizohet ai vendim.

Për çështjen e marrjes së kredisë nga BERZH-i diskutuan edhe: **Shpend Ahmeti, kryetar, Dardan Sejdiu, nënkryetar, Flamur Shala, Muhamet Selmani, Qëndron Kastrati, Sami Borovci dhe Feti Mehdiu**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u mor qëndrim që në rend dite të futet Propozimvendimin për dhënien e garancisë ndërmarrjes publike lokale "Trafiku Urban".**

**Shpend Ahmeti**, kryetar, propozoi që në rend dite të futet për diskutim edhe çështja e Pallatit të rinisë.

Për propozimin që të diskutohet rreth çështjes së Pallatit të rinisë, diskutuan edhe: **Sami Hamiti, Qëndron Kastrati, Sylejman Pireva dhe Lirak Çelaj**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoj se u mor qëndrim që në rend dite të futet edhe Deklarata për fillimin e negociatave për Pallatin e Rinisë, për kthimin e tij në ndërmarrje publike lokale.**

Para se të votohet rendi i ditës, **Sadri Ramabaja** propozoi që në rend dite të futet edhe çështja e emërimit ( ndryshimit) të disa rrugëve nga Komisioni për emërtimin dhe zyrtarizimin e rrugëve, rrugicave dhe shesheve në Komunën e Prishtinës. Po ashtu kërkoi të futet edhe çështja e gjetjes së një lokacioni për ndërtimin e Sinagoges për bashkësinë hebreje.

Për çështjen e ndërtimit të sinagogës, **kryetari** dha sqarime të nevojshme.

**Kryesuesi** konstatoj se njëzëri u miratua ky

### **R e n d d i t e:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës;**
- 2. Propozimvendimi për garancinë e borxhit për NPL "Trafikut Urban";**
- 3. Propozimvendimi për dhënien e autorizimit kryetarit të Komunës për inicimin e procedurave për kthimin e Pallatit të Rinisë në ndërmarrje publike lokale;**
- 4. Propozimvendimi për miratimin-lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes "Mati 2";**
- 5. Propozimvendimi për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit rregullues të lagjes "Sofalia";**
- 6. Propozimvendimi për miratimin-lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes "Kodra e Trimave 1";**

7. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifrat për rregullimin e infrastrukturës;
8. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të hapësirave SHML "Gjimnazi Matematikorë" për Institutin ndërkombëtar të inteligjencës të jashtëzakonshme "Atomi";
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronave të Komunës me prona private;
10. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016;
11. Propozimvendimi për shqyrtimin e petitionit të banorëve të lagjes Prishtina e re - Zona perëndim" sipas rekomandimeve të ministrisë.

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës.**

#### **Pika e dytë**

**Propozimvendimi për garancinë e borxhit për NPL "Trafikut Urban";**

Për këtë pikë, kryesuesi hapi diskutimin.

Për garancinë e borxhit për NPL Trafiku urban" diskutuan: **Sami Hamiti, Mirlinda Sopi, Ylli Hoxha, Dardan Sejdiu, nënkryetar, Feti Mehdiu dhe Flamur Shala,** diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për garancinë e borxhit për NPL "Trafikut Urban.**

#### **Pika e tretë**

**Propozimvendimi për dhënien e autorizimit kryetarit të Komunës për iniciimin e procedurave për kthimin e Pallatit të Rinisë në ndërmarrje publike lokale**

Për këtë propozimvendim, kryesuesi hapi diskutimin

Për propozimvendimin diskutuan: **Shpend Ahmeti, kryetar, Sami Hamiti, Shemsi Veseli, Sadri Ramabaja, Mirlinda Sopi, Fadil Gashi, Feti Mhediu, Visar Arifaj, Abetare Fazliu, Ylli Hoxha, Shefki Gashi dhe Sylejman Pireva,** diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për dhënien e autorizimit kryetarit të Komunës për iniciimin e procedurave për kthimin e Pallatit të Rinisë në ndërmarrje publike lokale.**

## **Pika e katërt**

### **Propozim vendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozim planit rregullues të lagjes "Mati 2"**

**Kryesuesi** hapi diskutimin për Propozim planin rregullues të lagjes "Mati 2"

Përfaqësuesi i kompanisë projektuese "Infra Plus", bëri prezantimin në mënyrë elektronike të propozimplanit rregullues të lagjes "Mati 2", duke elaboruar disa nga komponentet më kryesore të këtij propozimplanit rregullues.

Për këtë propozim plan rregullues diskutuan: **Mustafë Krasniqi, Qëndron Kastrati, Shemsi Veseli, Mirlinda Sopi, Rrita Begolli, Feti Mehdiu, Ylli Hoxha, Muhamet Selmani, Sami Hamiti, Flamur Shala, Sylejman Pireva, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë për planifikim strategjik, Sadri Ramabaja, Shaip Hajrizi, Kimet Zeqa, Visar Arifaj dhe Florim Krasniqi, përfaqësuesi Drejtorisë së Urbanizmit**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se me 19 ( nëntëmbëdhjetë) vota për, 10 ( dhjetë) abstenime (përfaqësuesit e subjekteve politike të LDK-së dhe të PDK-së), u miratua vendimi për miratimin - lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozim planit rregullues të lagjes "Mati 2".**

## **Pika e pestë**

### **Propozim-vendimi për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit rregullues të lagjes "Sofalia"**

Për këtë pikë, **kryesuesi** hapi diskutimin

Përfaqësuesi i kompanisë "Vizion Plus", në mënyrë elektronike bëri prezantimin e këtij plani, duke elaboruar disa nga komponentet më kryesore të tij.

Për propozim planin rregullues të lagjes "Sofalia", diskutuan: **Ylli Hoxha, Laura Zherka, Muhamet Selmani, Qëndron Kastrati, Flamur Shala, Shemsi Veseli dhe Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së planifikimit strategjik**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Me 21 ( njëzet e një ) vota për, 17 ( shtatëmbëdhjetë ) abstenime ( përfaqësuesit e subjektit politik të LDK-së), u miratua Vendimi për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit rregullues të lagjes "Sofalia".**

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për lënie në dispozicion për diskutim publik planit rregullues të hollësishëm të lagjes “ Kodra e Trimave 1”**

Përfaqësuesi i kopmanisë projektuese “A design”, bëri prezantimin në mënyrë elektronike të propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes “Kodra e trimave 1”, duke elaboruar disa nga komponentet më kryesore të këtij propozimplanit rregullues.

Për këtë propozim plan rregullues diskutuan: **Visar Arifaj, Ylli Hoxha, Kimet Zeqa, Sylejman Pireva dhe Sadri Ramabaja**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**U konstatua se me 21 ( njëzet e një) vota për, 13 ( trembëdhjetë) abstenime (përfaqësuesit e subjekteve politike të LDK-së dhe të PDK-së), u miratua Vendimi për lënie në dispozicion për diskutim publik planit rregullues të hollësishëm të lagjes “Kodra e Trimave 1”.**

#### **Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës.**

#### **Pika e tetë**

**Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të hapësirave SHML “Gjimnazi Matematikorë” për Institutin ndërkombëtar për inteligjencë të jashtëzakonshme “Atomi”.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të hapësirave SHML “Gjimnazi Matematikorë” për Institutin ndërkombëtar për inteligjencë të jashtëzakonshme “Atomi”**

#### **Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronave të Komunës me prona private**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për këmbimin e pronave të Komunës me prona private.**

#### **Pika e dhjetë**

**Caktimi i anëtarëve të komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua Vendimi për caktimi i anëtarëve të komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016.**

**Pika e njëmbëdhjetë**

**Shqyrtimi i vendimit për pranimin e kërkesave të parashtruesve të petitionit të grupit të qytetarëve të lagjes " Prishtina e Re Zona perëndim".**

Për këtë pikë diskutuan: **Sami Hamiti, Genc Bashota, Ardian Olluri, shef i zyrës ligjore, Qëndron Kastrati, Ylli Hoxha dhe Sadri Ramabaja**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Para se të qitet në votim vendimi për shqyrtimin e petitionit të banorëve të lagjes "Prishtina e re - Zona perëndim", **kryesuesi** tha se vendimi i cili është marrë në këtë Kuvend më 29.09.2015, ai tani duhet të korrigjohet sipas rekomandimeve të Ministrisë së planifikimit.

**Kryesuesi konstatoi se me 23 ( njëzet e tre) vota për, 5 ( pesë) abstenime, u miratua Vendimi për shqyrtimin e petitionit të banorëve të lagjës "Prishtina e re - Zona perëndim".**

**Mbledhja përfundoi në orën 17:20.**

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Halim Halimi, jur. i dipl.**